



ANEKS 3. Raporti i Progresit për Shqipërinë - Vlerësimi ndër vite nga KE

Kapitulli 32 / Shqipëria	Raport Progres 2020 Mars 2020 / KE vendos hapjen e negociatave me Shqipërinë					
	Raport Progres 2021	Raport Progres 2019	Raport Progres 2018	Raport Progres 2016	Raport Progres 2015	
Opinionin i KE / Përgatitja	Shqipëria ka një përgatitje modeste, ne kete kapitull	Shqipëria ka një përgatitje modeste, ne kete kapitull	Shqipëria ka një përgatitje modeste, ne kete kapitull	Shqipëria ka një përgatitje modeste, ne kete kapitull	Shqipëria ka një përgatitje modeste, ne kete kapitull	
Përmbledhje / Progresi 2021	Njëfarë progresi u bë gjatë periudhës raportuese, veçanërisht me miratimin e një dokumenti të politikave për forcimin e kontrollit të brendshëm financiar publik (KBFP), udhëzime mbi delegimin e përgjegjësisë financiare, udhëzime për monitorimin dhe raportimin mbi ndjekjen e rekomandimeve të auditit të brendshëm dhe rishikimin e kontrollit të cilësisë së auditit të jashtëm dhe procedurat e sigurimit të cilësisë.	Njëfarë progresi u bë gjatë periudhës raportuese, veçanërisht me ratifikimin e konventës ndërkombëtare kundër falsifikimit të monedhës dhe miratimin e një metodologjie të rishikuar për mbikqyrjen e performancës të kontrollit të brendshëm.	Njëfarë progresi u bë gjatë periudhës raportuese me miratimin ligjor të një mekanizmi për koordinimin, mbikqyrjen dhe raportimin e reformave kyçe mbi qeverisjen e mirë, duke përfshirë kontrollin e brendshëm financiar publik (KBFP) dhe me miratimin e një qasjeje të kontrollit të jashtëm bazuar në rrezikun	Njëfarë progresi u bë gjatë periudhës raportuese, veçanërisht me rritjen e ndërgjegjësimit mbi përgjegjshmërinë administrative, pilotimin e manualit të kontrollit të jashtëm në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe vendosjen e treguesve të kontrollit të cilësisë.	Njëfarë progresi u bë gjatë vitit të kaluar, veçanërisht në amendimin e legjislacionit të kontrollit të brendshëm financiar publik (KBFP) në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke ripërqendruar rolin e Njësive Qendrore të Harmonizimit (NJOH) në aktivite me strategjike dhe duke përmirësuar manualin e kontrollit të jashtëm në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI).	Njëfarë progresi u bë gjatë vitit të kaluar, veçanërisht në miratimin e një strategjie të rësore të reformës së menaxhimit financiar publik dhe një ligji të amenduar të institucionit të Kontrollit të Lartë Shtetëror (KLSH).
Përmbledhje / Analiza e gjetjeve 2021	Funksionimi i duhur dhe efektivi i kontrollit të brendshëm nuk është siguruar ende nëpërmjet njësive buxhetore. Meqenëse u bë vetëm përparim i pjesshëm me rekomandimet e Komisionit për vitin 2020, këto mbeten të vlefshme. Në vitin që vjen, Shqipëria duhet në veçanti:	Shqipëria nuk ka miratuar ende një dokument politik tërësor të kontrollit të brendshëm financiar publik (KBFP), bazuar në përgjegjshmërinë menaxheriale dhe nuk ka bere amendamentet e kërkuara në legjislacion. Funksionimi i duhur dhe efektivi i kontrollit të brendshëm nuk është siguruar ende nëpërmjet njësive buxhetore. Zbatimi në kohë i rekomandimeve të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm duhet të përmirësohet më tej. Meqenëse u bë vetëm përparim i pjesshëm me rekomandimet e Komisionit për vitin 2019, këto mbeten të vlefshme. Në vitin që vjen, Shqipëria duhet në veçanti:	Shqipëria nuk ka miratuar ende, mbetet për t'u miratuar një dokument tërësor politik i KBFP, bazuar në përgjegjshmërinë menaxheriale dhe të gjitha ndryshimet legjislative të kërkuara. Funksionimi i duhur dhe efektivi i kontrollit të brendshëm nuk është siguruar ende në të gjitha njësitë buxhetore dhe zbatimi në kohë i rekomandimeve të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm duhet të përmirësohet. Meqenëse u bë vetëm përparim i pjesshëm me rekomandimet e Komisionit për vitin 2018, këto mbeten të vlefshme. Në vitin që vjen, Shqipëria duhet në veçanti:	Disa institucione nuk zbatojnë plotësisht legjislacionin e kontrollit të brendshëm financiar publik (KBFP) dhe norma e zbatimit të rekomandimeve të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm mbetet e ulët. Rekomandimet e Komisionit për vitin 2016 u zbatuan pjesërisht. Në vitin që vjen, Shqipëria duhet në veçanti:	Shumë institucione nuk zbatojnë përgjegjshmëri menaxheriale dhe kontrolli të brendshëm në përputhje me legjislacionin KBFP. Kjo gjithashtu ndikon negativisht në zhvillimin e duhur të kontrollit të jashtëm, pasi KLSH vazhdon të përqendrohet kryesisht në auditimet e përputhjes dhe zbulimin e parregullsive. Në vitin që vjen, Shqipëria duhet në veçanti:	Parimi i logaridhënies menaxheriale nuk është ende plotësisht i mishëruar në kulturën e menaxhimit dhe legjislacioni i kontrollit të brendshëm financiar publik (KBFP) nuk zbatohet sistematikisht nga të gjitha institucionet. Në vitin e ardhshëm Shqipëria duhet në veçanti:
Rekomandimet	1. Të zbatojë udhëzimet mbi delegimin financiar të përgjegjësive dhe të lëshojë udhëzime mbi delegimin e përgjegjësisë menaxhuese me synimin për të përmirësuar përgjegjshmërinë menaxheriale; 2. Të monitorojë dhe të ndjekë zbatimin e rekomandimeve të bëra në raportin vjetor të KBFP-së nëpër institucionet buxhetore; 3. Rritja e kontrollit parlamentar ndaj organeve të audituara në zbatimin e rekomandimeve të auditit të jashtëm, nëpërmjet seancave më të shpeshta parlamentare dhe ngritjes së një kuadri parlamentar të mbikqyrjes për të vlerësuar rregullisht procesin monitorues të rekomandimeve nga ana e qeverisë.	1. Të miratojë dhe të fillojë zbatimin e një dokumenti gjithëpërfshirës të politikave të KBFP-së me fokus të veçantë në përcaktimin dhe zbatimin e kuadrit menaxherial të logaridhënies dhe monitorimit që koordinon KBFP-në me reformat e administratës publike dhe të menaxhimit financiar publik; 2. Të përmirësojë zbatimin e raportit vjetor të KBFP-së nëpër njësitë buxhetore; 3. Rritja e kontrollit parlamentar ndaj organeve të audituara në zbatimin e rekomandimeve të auditit të jashtëm, nëpërmjet seancave më të shpeshta parlamentare dhe ngritjes së një kuadri parlamentar të mbikqyrjes monitorues të rekomandimeve nga ana e qeverisë.	1. Të miratojë dhe të fillojë zbatimin e një dokumenti gjithëpërfshirës të politikave të KBFP-së me fokus të veçantë në përcaktimin dhe zbatimin e përgjegjshmërisë menaxheriale dhe të sigurojë monitorimin dhe raportimin e koordinuar të të gjitha reformave të lidhura; 2. Të sigurojë ndjekjen efektive të raportit vjetor KBFP duke trajtuar dobësitë sistematike; 3. Të sigurojë zbatimin më sistematik dhe në kohë të rekomandimeve të auditit të jashtëm.	1. Përgatit një dokument të plotë të politikave KBFP me fokus specifik në përgjegjshmërinë menaxheriale 2. Të sigurojë ndjekjen efektive të vlerësimit vjetor të KBFP-së duke trajtuar dobësitë sistematike, veçanërisht në delegimin e detyrave dhe raportimit të performancës; 3. Të miratojë një qasje të kontrollit të jashtëm bazuar në rrezikun ku të përkrahur se si do të ulet gradualisht numri i auditimeve të përputhjes dhe të shtohen auditimet financiare dhe të performancës.	1. Të ofrojë një vlerësim të institucioneve të mëdha shpenzues, të cilat ende nuk kanë ose zbatojnë plotësisht rregulloret dhe procedurat e brendshme mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditin e brendshëm dhe sigurojnë që qeveria të lëshojë udhëzime dhe rekomandime për këto institucione në mënyrë që operacionet e tyre të përputhen me kërkesat ligjore; 2. Të sigurojë ndjekjen efektive të vlerësimit vjetor të KBFP-së që trajton dobësitë sistematike veçanërisht në fushat e delegimit të detyrave dhe raportimit të performancës; 3. Të rrisë numrin e auditimeve financiare dhe të përputhjes/regullatore pilot nga KLSH në përputhje me manualin e rishikuar të auditit dhe standardet e auditimit të INTOSAI-t.	1. Të miratojë ndryshime në legjislacionin e KBFP-së; 2. Të forcojë ndjekjen e vlerësimit vjetor të KBFP-së që trajton dobësitë sistematike; 3. Të sigurojë cilësinë e kontrollit të jashtëm duke i përputhur më tej operacionet e KLSH sipas standardeve të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI).

Burimi: KE: Vlerësimet numerike janë vendosur bazuar në opinionin e KE lidhur me përgatitjen dhe progresin e bere nga shteti per zbatimin e detyrimeve te anetaresimit ne BE
 (1) Faze fillestare, (2) Nivel i ulët përgatitje, (3) Përgatitje modeste, (4) Nivel i mirë përgatitje, (5) Përgatitje e avancuar.